



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



Drejtoria Për Bujqësi, Pylltari
Dhe Zhvillim Rural

08 Nr. _____ /2023

Dt. 27 / 10 /2023

Në kuadër të implementimit të marrëveshjes në mes të Komunës së Deçanit dhe Organizatës për Zhvillim Rural "Mëshqerra" nënshkruar më datë: 26.10.2023, me numër të Prot: 36637, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural bën:

FTESË PUBLIKE

Për aplikim në projektin:

- **Mbështetje fermerëve blegtorë me nga një mëshqerrë (lopë) barrëse të racës qumështore (Hollshtain Frizis)**

Projekti do të realizohet në bashkëfinancim me Organizatën për Zhvillim Rural "Mëshqerra" dhe fermerët përfitues.

Kushtet dhe kriteret për aplikim:

1. Të jetë banor i Komunës së Deçanit (kopja e letërnjoftimit);
2. Vërtetim nga AVUK për numrin e krerëve të lopëve;
3. Të posedojë stallë adekuate që i plotëson kushtet sipas standardeve;
4. Të posedojë 1 deri në 3 lopë qumështore;
5. Të posedojë së paku 0.50 ha tokë të punueshme bujqësore (Fletën Poseduese);
6. Përparësi do të kenë fermerët me kushte më të dobëta ekonomike;
7. Fermeri që është i gatshëm të participoj me 400 E dhe të nënshkruaj kontratë me Komunën dhe donatorët;
8. Të drejtë aplikimi nuk kanë fermerët (apo familjarët e ngushtë të fermerëve) të cilët kanë qenë përfitues nga dy kontingjentet e kaluar.

Mbështetja/Subvencionimi do të bëhet me një krerë lopë për fermer. Projekti do të zgjasë tri vjet (2023-2026). OZHR "Mëshqerra" do të participojë me 58.82 % të vlerës, Komuna e Deçanit do të participojë me 29.42 % të vlerës dhe fermerët përfitues do të participojnë me 11.76 % të vlerës së këtij projekti. Fermerët përfitues para lidhjes së kontratës do të bëjnë pagesën në llogarinë bankare të Organizatës për Zhvillim Rural "Mëshqerra" shumë kjo e cila do të ju kthehet fermerëve në tri vitet e ardhshme përmes ushqimit të koncentruar, shërbimeve veterinerë, trajnimeve dhe imputeve të ndryshme.

Afati i aplikimit: nga data 27.10.2023 deri me 10.11.2023

Aplikacionet dorëzohen në zyrat e DBPZHR-së në objektin e Komunës së Deçanit.

Drejtori i DBPZHR

Rifat STOJKAJ

Faqe 1 / 2

